

tjerët nuk dërgohen dhe këto quhen dënime jo nën mbikëqyrje.

Në disa raste gjykatësi e dënon kundërvajtësin menjëherë pasi ky i fundit është shpallur fajtor apo ka pranuar fajësinë.

Në raste të tjera ata do ta shtyjnë çështjen për një datë të mëvonshme për të mbledhur informacione rreth kundërvajtësit dhe për të shqyrtuar mundësitë e disponueshme të dënimit. Raportet me informacionet e mbledhura e ndihmojnë gjykatësin që të vendosë mbi mënyrën më të mirë për ta trajtuar çështjen.

Kur kundërvajtësi ndodhet në burg gjatë procesit gjyqësor, gjykatësi do të vendosë nëse ai duhet të lirohet me dorëzani derisa të jepet dënimi. VIA do t'ju bëjë të ditur nëse kundërvajtësi është liruar me dorëzani apo ndodhet nën arrest.

Ne gjithashtu do t'ju bëjmë të ditur dënimin e dhënë në lidhje me çështjen që ju prek juve (megjithëse ju mund të jeni vetë i pranishëm në gjykatë për ta dëgjuar këtë). Fletëpalosja e VIA-s mbi *Informacionet rreth vendimeve* ju tregon më shumë sesi gjykatësi merr një vendim dhe se çfarë nënkupton ky i fundit.

## Apeli

Kundërvajtësi mund të apelojë kundër dënimit dhe/ose vendimit. Pala akuzuese mund të apelojë vetëm kundër vendimit gjyqësor dhe vetëm në disa rrethana të caktuara. Kundërvajtësi mund të lirohet pas vendimit gjyqësor deri në seancën e apelit nëse gjykatësi vendos për atë që quhet lirim i

përkohshëm. VIA do t'ju bëjë të ditur nëse ndodh kjo.

Nëse zhvillohet apeli në çështjen që ju prek juve, VIA do t'ju bëjë të ditur. Ne gjithashtu do t'ju dërgojmë një kopje të fletëpalosjes së VIA-s mbi *Informacionet rreth apeleve* e cila jep shpjegime të mëtejshme.

## Mbështetja

Ju mund të dëshironi të kontaktoni:

**Victim Support Scotland (Mbështetjen për Viktimat Skoci)** e cila ofron mbështetje praktike dhe emocionale për viktimat e krimit. Për detaje rreth vendit kontaktoni në numrin 0845 60 39 213 gjatë orarit zyrtar ose vizitoni faqen e internetit [www.victimssupportsco.org.uk](http://www.victimssupportsco.org.uk)

**The Witness Service (Shërbimin për dëshmitarët)** i cili ofron mbështetje praktike dhe emocionale për të gjithë viktimat dhe dëshmitarët si dhe për familjet dhe miqtë e tyre gjatë kohës kur marrin pjesë në gjyq. Për detaje rreth vendit të Shërbimit për Dëshmitarët ju lutem kontaktoni Mbështetjen për Viktimat Skoci. Gjithashtu VIA mund t'ju vërë në kontakt me organizata të tjera të që ofrojnë mbështetje.

## Informacione të mëtejshme

Ju lutemi drejtojeni VIA-s nëse dëshironi informacione të mëtejshme ose nëse ka diçka për të cilën nuk jeni i sigurt.

Ju mund të kontaktoni zyrën e VIA-s në vendin tuaj në numrin e telefonit që ndodhet në letrën e bashkëngjitur.

Po kështu ju lutem kontaktoni Ekipin Kombëtar VIA:

me telefon në numrin 01389 739557

me faks në numrin 0844 561 4180

me email në adresën:  
[vianationalteam@copfs.gsi.gov.uk](mailto:vianationalteam@copfs.gsi.gov.uk)

Organizata për informimin dhe këshillimin e viktimave  
Pjesë e departamentit ministror të Zyrës Mbretërore dhe Shërbimit të prokurorit fiskal  
© Të drejtat e autorit i përkasin Zyrës Mbretërore 2003 të rishikuara në nëntor 2008 APS Group Scotland 136008 05/10

**VIA – Organizata për informimin dhe këshillimin e viktimave**

**Informacion  
Rreth procedurës gjyqësore me gjykatës dhe juri**

**Ju lutemi të kontaktoni VIA-n nëse e dëshironi këtë dokument në një tjetër gjuhë, me**

	<p>shkronja të mëdha, audio, Braille ose në një tjetër format. Mirëpresim telefonatat nëpërmjet sistemit të komunikimit të RNID për personat që nuk dëgjojnë me prefiks 18001.</p>
<p><b>Hyrje</b>  <b>Organizata për informimin dhe këshillimin e viktimave (VIA)</b> ju ka dhënë juve këtë fletëpalosje sepse ju jeni viktimë i/e dhe/ose dëshmitar i/e një krimi. Prokurorët e lartë (Prokuroria e Përgjithshme) kanë vendosur që kjo çështje duhet të zhvillohet në Gjykatën e Rrethit. Në një gjyq me pjesëmarrjen e një gjykatësi dhe një jurie, juria (e përbërë nga 15 anëtarë zyrtarë) merr vendimin dhe gjykatësi vendos për çdo lloj vendimi gjyqësor.</p> <p>Në seancat gjyqësore me juri dhe gjykatës të akuzuarit i jepet një aktakuzë (dokument ligjor) e cila parashtron akuzën/akuzat kundrejt tij. Gjithashtu ajo përfshin një listë të dëshmitarëve, sendeve ose dokumenteve (të quajtura paraqitja e dokumenteve si pjesë e procesit të mbledhjes së fakteve) të cilave mund t’iu referohet gjatë çdo procesi gjyqësor.</p> <p>Kjo fletëpalosje përshkruan etapat e seancës gjyqësore me juri dhe gjykatës, dhe ju tregon se kur duhet që dëshmitarët të paraqiten në gjykatë.</p> <p><b>Rreth VIA-s</b>  Fletëpalosja, <i>VIA – si mund t’ju ndihmojmë</i>, shpjegon se çfarë bën VIA dhe se çfarë mund të bëjmë ne për t’ju ndihmuar juve.</p> <p>Nëse ju nuk e doni ndihmën e VIA-s, ju lutemi të na e bëni të ditur. Nëse më pas ju ndërroni mendje, ju lutemi që të na kontaktoni.</p> <p>Ne shpresojmë se kjo fletëpalosje do t’i përgjigjet disa prej pyetjeve që ju mund</p>	<p>Paragrafët që vijojnë shpjegojnë fazat e ndryshme të procesit gjyqësor.</p> <p><b>Seanca e parë (dëshmitarëve të cilët mund të thirren për të dhënë dëshmitë e tyre gjatë çështjes u kërkohet që mos të marrin pjesë për shkak se kjo mund të rrezikojë çështjen)</b></p> <p>Në këtë seancë dëgjimore akuza dhe mbrojtja do t’i bëjnë të ditur gjykatësit nëse ata janë gati që çështjen ta paraqesin në gjyq. Nëse po, atëherë gjykatësi do të caktojë një datë për gjyqin.</p> <p>Nëse nuk janë gati, çështja do të "vazhdohet". Kjo do të thotë se do të ketë një tjetër seancë dëgjimore. Kjo mund të ndodhë më shumë se njëherë. Data e gjyqit do të vendoset kur akuza dhe mbrojtja të jenë tërësisht të përgatitura.</p> <p>I akuzuari mund të pranojë fajësinë që në seancën e parë. Nëse ndodh kështu atëherë gjykatësi mund ta japë vendimin gjyqësor që në atë moment ose ta azhurnojë (shtyjë) çështjen për një datë të mëvonshme (shihni paragrafin mbi vendimin gjyqësor).</p> <p>Nëse i akuzuari nuk e pranon fajësinë, çështja shkon në gjyq ku do të mbahet seanca gjyqësore me praninë e gjykatësit dhe jurisë. Ky është momenti kur një sërë gjyqesh vendosen për një periudhë të caktuar. Gjyqi për çështjen që ju prek juve do të fillojë në një kohë të caktuar gjatë kësaj periudhe. VIA do t’jua bëjë të ditur se kur.</p> <p><b>Gjyqi (dëshmitarët duhet të marrin</b></p> <p>dëshmi, do t’ju dërgohet një thirrje (letër) për të dëshmuar, e cila jep datën dhe kohën se kur duhet të vini në gjykatë. Nëse nuk mund të paraqiteni në gjykatë në datën e caktuar ju duhet të kontaktoni menjëherë prokurorin ose VIA-n.</p> <p>Juve do t’ju dërgohet një broshurë e titulluar <i>Dëshmitar në Gjykatë me Juri dhe Gjykatës</i> bashkë me letrën. Ajo jep informacion se çfarë duhet të sillni në gjykatë, çfarë do të ndodhë kur të arrini aty dhe çfarë shpenzimesh mund të pretendoni.</p> <p>Ndoshta do t’ju duhet të prisni për njëfarë kohe në gjykatë përpara se t’ju kërkohet të hyni në sallën e gjyqit. Në varësi të ecurisë së gjyqit, mund t’ju kërkohet të jepni dëshmi ose mund t’ju thuhet të vini sërish një ditë tjetër.</p> <p>Në gjyq juria do të dëgjojë të gjitha provat dhe do të vendosë nëse vendimi i marrë do të jetë <b>"fajtor"</b>, <b>"i pafajshëm"</b> apo <b>"i pavërtetuar"</b>. Nëse vendimi gjyqësor është "i pafajshëm" ose "i pavërtetuar", i akuzuari mund të largohet nga gjykata dhe ky është fundi i çështjes. Nëse i akuzuari shpallet fajtor apo pranon fajësinë atëherë ai do të marrë dënimin në atë moment ose në një datë të caktuar.</p> <p><b>Pranimi i fajësisë nga i akuzuari</b>  I akuzuari mund të pranojë fajësinë gjatë seancës së parë ose gjyqit. Nëse VIA e kupton se i akuzuari ka ndërmend ta bëjë këtë gjë, ne do të bëjmë më të mirën për t’jua bërë të ditur. Por i akuzuari mund të vendosë ta pranojë</p> <p><b>Mbështetja suplementare.</b>  Përfshirja në një sistem drejtësie penale mund të jetë i rikshëm, dhe ju mund të ndiheni nervoz për faktin se duhet të jepni dëshmi në një gjyq. Ju ndoshta nuk mund ta dini se çfarë prisni.</p> <p>Shërbimi për dëshmitarët ofron mbështetje praktike për dëshmitarët në gjyq. VIA gjithashtu mund të bëjë të mundur që Shërbimi për dëshmitarët t’ju tregojë juve ambientet e gjykatës përpara seancës gjyqësore. Ne do t’ju pyesim nëse ju dëshironi që ne ta bëjmë këtë për ju.</p> <p>Gjithashtu VIA mund t’ju ndihmojë nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• gjuha juaj e parë ose e preferuar nuk është anglishtja dhe juve ju duhet ndihmë për të kuptuar dokumentet apo të jepni dëshmi.</li> <li>• ju keni vështirësi për të ardhur apo për t’u orientuar në gjykatë.</li> <li>• ju mendoni se mund të keni nevojë për mbështetje për t’ju ndihmuar në dhënien e dëshmisë.</li> </ul> <p>Ju lutem tregojini VIA-s nëse keni ndonjë shqetësim apo nevojë specifike. Ne do të diskutojmë se çfarë mbështetje mund të jetë e disponueshme dhe do të sigurohemi se prokurori dhe gjykata janë në dijeni të këtyre çështjeve.</p> <p><b>Vendimi gjyqësor</b>  Nëse një person i akuzuar pranon fajësinë ose shpallet fajtor, ju mund të dëgjoni se atyre u drejtohet si "kundërvajtësi". Gjykatësi mund të zgjedhë llojin e vendimit gjyqësor që do të japë midis një game të gjerë mundësish. Disa nga mundësitë</p>

të keni. Ju lutemi të na pyesni nëse ka diçka tjetër që ju dëshironi të dini ose për të cilën jeni të pasigurt.

**pjesë)**

Nëse është e nevojshme që ju të jepni

fajësinë në momentin e fundit.  
Gjithashtu ai mund të ndryshojë mendje rreth shpalljes fajtor derisa kjo të bëhet në gjykatë.

përfshijnë dërgimin e të akuzuarit në burg ose në Institucionin e Korrektimit të të Miturve (dënim nën mbikëqyrje). Të